REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

**Procesverbali - TAKIMI PUBLIK ME QYTETARË**

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Salla e Kuvendit Komunal në Pejë

Takimi ka filluar në ora: 12:00

Datë: 20.06.2024

Në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës është mbajtur takimi publik me qytetarë, ku të gjithë të interesuarit janë informuar drejtpërdrejt nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri dhe Drejtorët e Drejtorive të SHCK-së, në Pejë për të gjitha çështjet nga kompetenca e pushtetit lokal me të cilat preokupohen dhe për të cilat kanë shprehur interesim, siç janë: punët e Komunës së Pejës, prioritetet e Komunës së Pejës, infrastrukturën rrugore, infrastrukturën komunale, shërbimet administrative komunale, buxhetin etj.

Në takim kanë marrë pjesë Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Nënkryetari i Komunës së Pejës për Komunitete, z.Mirzet Dzogovic, Drejtorët e Drejtorive, Kryetarët e Bashkësive Lokale dhe qytetarë të Komunës së Pejës.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe Ju uroj mirëseardhje në takimin publik me qytetarë, i cili theksoi s’e ky takim mbahet në kuadër të objektivave të komunës për transparencë dhe shërben si njoftim rreth punëve të Komunës ku qytetarët kanë mundësi t’i japin

sugjerimet dhe t'i parashtrojnë kërkesat dhe ankesat e tyre.
1

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të pranishmit, të cilët i njoftoi për punët, që janë kryer gjatë këtij 6 mujori.
Drejtoria për Administratë për këtë 6 mujor i ka kryer 43 mijë lëndë, për të cilat kanë marrë përgjigje qytetarët për çështje të ndryshme, prej certifikatës së lindjes deri te certifikatat e vdekjes, kurorëzimet etj. I kemi ndërtuar dy shkolla njëra është në fshatin Poçestë në përfundim e sipër, aneksin e shkollës në Trestenik, në Zllapek jemi t'u e punu një aneks të ri, shkollën në Loxhë, jemi t'u e punu sallën e sportit në Treboviq, i kemi edhe disa renovime me i përfundu nëpër shkolla për me i përgatit për vitin e ri shkollor në shtator, ndërsa sa i përket kanaleve janë përfunduar shumica dhe këtë vit Drejtoria e Bujqësisë ka ndarë shumë subvencione për fermerë, ndërsa këtë vit kanë përfunduar punimet në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Vitomiricë, është përfundu edhe Ambulanta në Bogë, ndërsa javën tjetër e inaugurojmë Ambulantën në Karagaq, para disa muajve është inauguruar objekti i ri i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, po ashtu i njoftoi s'e me projektin e grantit të performancës, me DEMOS-in dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal janë 22 projekte dhe jemi orientuar kryesisht në trotuare dhe ndriçim publik për ta rritur sigurinë e qytetarëve, jemi të orientuar në fshatrat, të cilat lidhen me qytetin Loxha, Novosella, Vitomirica, Llozhani, pastaj te Sharra me kriju një bazen tjetër pak më të madh, për rekreacion dhe freskim, rregullimi i kanalit të Çokolicës, ndërsa për qentë endacak e kemi zhvilluar procedurën, objekti ka avancu mjaft, ku do të trajtohen qentë, po ashtu është duke vazhduar impianti për trajtimin e mbeturinave në Sverkë, ujësjellësi i Lugut të Baranit do të lidhet te rrethi në Vitomiricë, ku do të bëhet lidhja kryesore edhe një tjetër është në rrugë të Zahaqit, ndërsa sa i përket rrugës së Rugovës ajo është në domenin e Ministrisë së Infrastrukturës, po ashtu theksoi s'e e kemi sfidë të madhe dëmtimin e rrugëve, që është duke u bërë nga "Hidrodrini" për t'i kryer punët dhe shpresojmë, që këtë javë do t'i përfundojnë punimet, sepse po ka ngecje në trafik.

Kryesuesi Kurtbogaj e falënderoj Kryetarin Muhaxheri, ndërsa tani, po e hapim debatin dhe do t'ju jap fjalën me radhë qytetarëve, të cilët dëshirojnë të marrin fjalën.

-Agim Nikqi - Këshilli Lokal "Rrokaqielli" i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e i ka disa kërkesa, ku disa prej kërkesave i kam dorëzu dhe shpresoj, që do të kryhen.

Unë kam kërku në rrugën "Vëllezërit Gërvalla" të rregullohet këndi i lojërave për fëmijë në rrugën, prej shkollës fillore vendosja e laurave, si dhe për dëme deshta me ditë te kush të drejtohem për dëmet e shkaktuara nga vërshimet, sepse çdo ditë, po më pyesin qytetarët për dëmet e shkaktuara nga vërshimet.

-Kryetari Muhaxheri e njoftoj z.Nikqi s'e i kemi formu dy komisione, ku në njërin, prej tyre ka qenë edhe një përfaqësues i Ministrisë, ku janë evidentuar dëmet për biznese dhe dëmet për ekonomi familjare ato kanë shku për pagesë dhe janë miratu nga komisioni i Ministrisë dhe për shkak të një vendimi, të cilin e ka bërë gabim Ministria ato kanë mbet pa u ekzekutu. Tash kur të merr vendim Qeveria do t'ju bëhet pagesa të gjithë atyre, të cilët kanë apliku, ndërsa ata, që kanë apliku pas afatit nuk trajtohen dhe as ne si Komunë nuk kemi si me i trajtu.

-Isuf Lajçi i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e jam mësimdhënës në shkollën fillore "Dardania" të Pejës faleminderit Kryetarit Muhaxheri më së shumti, që e keni realizu buxhetin e punëtorëve të arsimit, sepse punëtorët arsimor kanë përfituar, prej kontratës kolektive, pa shku nëpërmjet gjykatave, përmbaruesve privat, avokatëve etj. Jam banor i lagjes "Kristali" sa i përket kanalizimit jemi shumë keq, si edhe rrymës përtokë, ndërsa sa i përket Shtupeqit të Vogël, fshat nga i cili vi unë është fshati, i cili ka më së paku investime, nuk kemi asnjë milimetër rrugë të asfaltuar, po ashtu edhe Ju përgëzoj për punët, të cilat i keni përfunduar, por ka ende shumë punë për t'u realizuar. Ju faleminderit shumë!

-Kryetari Muhaxheri theksoi s'e kanalizimi në lagjen "Kristal" një pjesë e kemi qitë në tender për projekt, sepse nuk po bën më pa qenë projekti, ndërsa sa i përket fshatit Shtupeq i Vogël, operatori e ka kontratën për me punu të paktën do të duhej këtë vit ta asfaltonte deri te Shkëmbi i Peklenës me projekt si është e paraparë.

-Agron Sheremeti ju përshëndes të gjithëve dhe deshta të pyesë për rrugët pas përfundimit të projektit a ka Komuna ndonjë komision, i cili del dhe i vlerëson a është kthyer në gjendje të mëparshme dhe si kanë mbetur, sepse po ju tregoj një përvojë nga rruga "Dardania" punëkryesi i ka përfundu punët, por nuk e ka kthy në gjendjen si ka qenë rruga dhe në biseda me qytetarë më të vërtetë juve, po ju mbet faji, po Ju a keni ndonjë mekanizëm, që t'i kontrolloni ato rrugë, sepse kanë mbet shumë më keq sesa kanë qenë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrjen dhe kontributin e dhënë dhe shihemi në takimet e radhës, si dhe njëkohësisht ju uroj festën e Kurban Bajramit të gjithëve!

Rëndësi të posaçme në këto takime ka pjesëmarrja aktive e qytetarëve me ide dhe sugjerime për avancimin e punëve të institucioneve komunale.

Në këtë takim qytetarët janë informuar për të gjitha çështjet, të cilat ju kanë interesuar.

Pjesëmarrja e qytetarëve në këtë takim dëshmon përcaktimin për Demokraci, ku si parakusht kryesor nënkupton pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Ky takim mbahet në përputhje me detyrimet, që dalin nga neni 68, pika 68.1 dhe 68.2 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 91, paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Pejës.

Kryesuesi takimin e mbylli në ora 14:00.

Procesmbajtësi:

Ariana Lukaj

| Nr. | EMRI DHE MBIEMRI | VENDBANIMI/ORGANIZATA | GJINIA | NËNSHKRIMI |
|---|---|---|---|---|

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

***LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN PUBLIK ME QYTETARË***

Vendi:Salla e Kuvendit

Data:20.06.2024

Ora:12:00

| Nr. | EMRI DHE MBIEMRI | VENDBANIMI/ORGANIZATA | GJINIA | NËNSHKRIMI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Januz Hajzeraj | Pejë | M | |
| 2 | AGONIS THAQI | KLINË | M | |
| 3 | Lirie Gjikolli | Pejë | F | |
| 4 | BEJHAN KRASNIQI | B.L.K. KARAGAQ | M. | |
| 5 | Liridona Imeri Haxhaj | Pejë | F | |
| 6 | Fehmije Shatri-Zeka | Pejë | F | |
| 7 | Valbona Goga | Pejë | F | |
| 8 | MEJREME SHATRI | Pejë | F | |
| 9 | Haxhi Nikqi | Pejë | M | |
| 10 | HAKI LAJQI | PEJË | M | |
| 11 | Ramiz Qorraj | Drelaj | M | |
| 12 | Isuf Lajçi | PEJË | M | |
| 13 | [illegible] | PEJË | M | |
| 14 | DONJETA BERDYNAJ | NOVOSELLË | F | |
| 15 | SANEL HUKIĆ | Pejë | M | |
| 16 | ALBION KELMENDI | PEJË | M | |
| 17 | Luan Gashi | Pejë | M | |
| 18 | MIRANDA LUTA GASHI | PEJË | F | |
| 19 | Arbenita Fazli | PEJË | F | |

| Nr. | EMRI DHE MBIEMRI | VENDBANIMI/ORGANIZATA | GJINIA | NËNSHKRIMI |
|---|---|---|---|---|
| 82 | SINAN SHOSHI | PEJË | M | |
| 83 | ILIR VESELI | PEJË | M | |
| 84 | Agron Sherruchi | Pejë | M | |
| 85 | Mëmudhë Ahola | Pejë | F | |
| 86 | Valbona Gashi | Pejë | F | |
| 87 | Fatbardha Berisha-Hadërgjonaj | Pejë | F | |
| 88 | Leonora Shoshi | Pejë | F | |
| 89 | Fllanza Zhara | Pejë | F | |
| 90 | AGRON MYFTARI | Pejë | M | |
| 91 | Bekim Kelmendi | Pejë - GPD | M | |
| 92 | RINA MALA | PEJË | F | |
| 93 | VLERA PAJAZITI KUMNOVA | PEJË | F | |
| 94 | VALBONA AVDIJAJ | PEJË | F | |
| 95 | FAIK ZEKA | PEJË | M | |
| 96 | Donjeta Morina | Pejë | F | |
| 97 | FATAH BËRLAJOLLI | PEJË | M. | |
| 98 | REXHEP KURTBOGAJ | ZAHAQ - PEJË | | |
| 99 | KASTRIOT BEQAJ | PEJË | M | |
| 100 | Arianit Demaj | Pejë | M | |

| Nr. | EMRI DHE MBIEMRI | VENDBANIMI/ORGANIZATA | GJINIA | NËNSHKRIMI |
|---|---|---|---|---|
| 20 | Defrim Turku | Pejë | M | |
| 21 | Miloreta Zekaj | Pejë | F | |
| 22 | Besar Llozaj | Pejë | M | |
| 23 | [illegible] | Pejë | M | |
| 24 | AGIM NIKAJ | Pejë | M | |
| 25 | SHEFQET MURIQI | Pejë | M | |
| 26 | BESIM LULAJ | TREBOVIQ, PEJË | M | |
| 27 | EDISON MALOKU | PEJË | M | |
| 28 | ARJETA LULAJ | Pejë | F | |
| 29 | XAJE MALOKU | Pejë | M | |
| 30 | FLORIJE IBRAJ | Pejë | F | |
| 31 | NESRIJE KATANOLLI | Pejë | F | |
| 32 | Sylë Peci | Pejë | M | |
| 33 | Shqipe Rugovi | Pejë | F | |
| 34 | Afërdita Sylaj | Pejë | F | |
| 35 | Milot Berisha | Pejë | M | |
| 36 | ARTA NALLBANI | PEJË | F | |
| 37 | GËZIM GASHI | PEJË | M | |
| 38 | Nazret Hajrizi | Pejë | M | |
| 39 | EDONRETA BERISHA | PEJË | F | |
| 40 | ALBULENA BAJRAKTARI | RADAC-PEJË / DMS | F | |
| 41 | DAFINA DRAGAJ | Katundi i Ri | F | |
| 42 | Mirzet Džogović | Pejë | M | |
| 43 | FATMIR ASLLANI | LESHAN R. PEJË | M | |
| 44 | [illegible] Krasniqi | DOBËRDOL | M | |
| 45 | | | | |
| 46 | | | | |
| 47 | | | | |
| 48 | | | | |
| 49 | | | | |
| 50 | | | | |